



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:058438

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747298

KPPP.nr.990/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit "A.L." B.I., me NUI:811173476, me seli në Glllogoc, rruga "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci", përfaqësuar sipas autorizimit nga Hasan Haxhaj, avokat nga Glllogoci, kundër debitorit "Mineral" L.L.C., me NUI:810523094, me seli në Glllogoc, fshati Çikatovë e Vjetër, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.176/23 të datës 13.06.2023, të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit "Mineral" L.L.C., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.176/23 të datës 13.06.2023, të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.176/23 i datës 13.06.2023, i Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t'ia paguaj kreditorit shumën prej 104.00 € (një qind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.
- IV. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh, pas pranimit të aktvendimit, të paguaj garancinë në shumë prej 5,164.00 €.

- V. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “A.L.” B.I., ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.176/23 të datës 13.06.2023, me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.20220215 të datës 31.05.2022; Faturës Nr. 20220213 të datës 31.05.2022; Faturës Nr.20220211 të datës 31.05.2022; Faturës Nr.20220208 të datës 31.05.2022; Faturës Nr.20220207 të datës 31.05.2022; Faturës Nr.20220206 të datës 01.06.2022; Faturës Nr. 20220205 të datës 01.06.2022; Faturës Nr. 20220203 të datës 01.06.2022; Faturës Nr.20220204 të datës 01.06.2022; Faturës Nr.20220251 të datës 30.06.2022; Faturës Nr.20220320 të datës 29.08.2022; Faturës Nr.20220321 të datës 29.08.2022; Faturës Nr. 20220348 të datës 31.08.2022; Faturës Nr.20220349 të datës 31.08.2022; Faturës Nr.20220378 të datës 28.09.2022; Faturës Nr.20220375 të datës 28.09.2022; Faturës Nr.20220376 të datës 28.09.2022; Faturës Nr.20220377 të datës 28.09.2022; Faturës Nr.20220374 të datës 28.09.2022; Faturës Nr.20220373 të datës 28.09.2022; Faturës Nr. 20220475 të datës 18.11.2022; Faturës Nr.20220498 të datës 14.12.2022; Faturës Nr. 20220499 të datës 14.12.2022; Faturës Nr.20220500 të datës 14.12.2022; Faturës Nr.20220520 të datës 21.12.2022; Faturës Nr.20220521 të datës 21.12.2022; Faturës Nr. 20220522 të datës 21.12.2022; Faturës Nr.20220539 të datës 29.12.2022; Faturës Nr.20220202 të datës 01.06.2022; Faturës Nr.20220250 të datës 30.06.2022; Faturës Nr.20220283 të datës 21.07.2022; Faturës Nr.20220284 të datës 21.07.2022; Faturës Nr.20220285 të datës 21.07.2022; Faturës Nr.20220293 të datës 26.07.2022; Faturës Nr.20220292 të datës 26.07.2022; Faturës Nr.20220297 të datës 29.07.2022; Faturës Nr. 20220295 të datës 29.07.2022; Faturës Nr.20220296 të datës 29.07.2022; Faturës Nr.20220298 të datës 29.07.2022; Faturës Nr.20220121 të datës 31.03.2022; Faturës Nr.20220120 të datës 31.03.2022; Faturës Nr.20220127 të datës 31.03.2022; Faturës Nr.20220126 të datës 31.03.2022; Faturës Nr.20220125 të datës 31.03.2022; Faturës Nr.20220122 të datës 31.03.2022; Faturës Nr.20220123 të datës 31.03.2022; Faturës Nr.20220124 të datës 31.03.2022; Faturës Nr.20220140 të datës 23.04.2022; Faturës Nr.20220174 të datës 30.04.2022; Faturës Nr.20220252 të datës 30.06.2022; Faturës Nr.20220253 të datës 30.06.2022; Faturës

Nr.20220254 të datës 30.06.2022; Faturës Nr.20220255 të datës 30.06.2022; Faturës Nr.20220347 të datës 31.08.2022; Faturës Nr.20220350 të datës 31.08.2022; Faturës Nr.20220400 të datës 14.10.2022; Faturës Nr.20220401 të datës 14.10.2022; Faturës Nr.20220444 të datës 31.10.2022; Faturës Nr.20220445 të datës 31.10.2022; Faturës Nr.20220446 të datës 31.10.2022; Faturës Nr.20220469 të datës 18.11.2022; Faturës Nr.20220470 të datës 18.11.2022; Faturës Nr.20220471 të datës 18.11.2022; Faturës Nr.20220472 të datës 18.11.2022; Faturës Nr.20220473 të datës 18.11.2022; Faturës Nr.20220474 të datës 18.11.2022; Faturës Nr.20220487 të datës 24.11.2022; Faturës Nr.20220486 të datës 24.11.2022; Faturës Nr.20220523 të datës 21.12.2022; Faturës Nr.20220399 të datës 14.10.2022; Faturës Nr.20220153 të datës 27.04.2022; Faturës Nr. 20220149 të datës 27.04.2022; Faturës Nr. 20220150 të datës 27.04.2022; Faturës Nr.20220151 të datës 27.04.2022; Faturës Nr.20220152 të datës 27.04.2022; Faturës Nr.20220319 të datës 29.08.2022; Faturës Nr.202300052 të datës 16.02.2023 dhe Faturës Nr.202300090 të datës 25.03.2023, me të cilin ka detyruar debitorin që kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumën prej 5,164.00 €, me kamat ligjore 8% në vit, duke filluar nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, ashtu të bllokohen të gjitha llogaritë bankare pranë të gjitha bankave, po ashtu dhe me regjistrimin, konfiskimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorit deri në arritjen e borxhit në tërësi si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se të gjitha obligimet ligjore ndaj kreditorit sipas marrëveshjes që ka pasur me debitorin, ndërsa borxhi i mbetur nuk është shuma të cilën e kërkon kreditori , por vlera e obligimit ndaj kreditorit është 3,349.00 €. Tutje ka shtuar se kreditori nuk i ka kryer shërbimet siç duhet andaj edhe nuk i është bërë pagesa e borxhit, ndërsa në disa raste ka faturuar punën e njëjtë siç është rasti me faturën nr.20220486 në shumë prej 420 euro dhe faturën nr.20220499 në shumë prej 460 euro, ku të dy faturat mbajnë fletëdërgesën e njëjtë për automjetin e njëjtë me përshkrim të njëjtë, po ashtu edhe fatura nr.202300090 në vlerë prej 1,295.00 euro, mjeti i dërguar për riparim në këtë faturë nuk është dorëzuar nga personi përgjegjës i kompanisë. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit.

Kreditori përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke theksuar se pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në këtë procedurë pasi që kjo

procedurë nuk është procedurë e fakteve por procedurë rigoroze formale. Tutje ka shtuar se meqenëse pjesërisht e pranon obligimin e tij debitori, e në anën tjetër në tërësi është e qartë obligimi i të njëjtit ndaj kreditorit, e gjithashtu nuk e paraqet asnjë shkak të vetëm përmbarimor, i njëjti prapësimin e ka ushtruar vetëm për prolongimin e çështjes. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa urdhrin përmbarimor ta lë në fuqi si dhe të detyrohet debitori që kreditorit t'ia kompensoj shpenzimet e përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumë prej 156.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”* dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht Faturën Nr.20220215 të datës 31.05.2022; Faturën Nr. 20220213 të datës 31.05.2022; Faturën Nr.20220211 të datës 31.05.2022; Faturën Nr.20220208 të datës 31.05.2022; Faturën Nr.20220207 të datës 31.05.2022; Faturën Nr.20220206 të datës 01.06.2022; Faturën Nr. 20220205 të datës 01.06.2022; Faturën Nr. 20220203 të datës

01.06.2022; Faturën Nr.20220204 të datës 01.06.2022; Faturën Nr.20220251 të datës
30.06.2022; Faturën Nr.20220320 të datës 29.08.2022; Faturën Nr.20220321 të datës
29.08.2022; Faturën Nr. 20220348 të datës 31.08.2022; Faturën Nr.20220349 të datës
31.08.2022; Faturën Nr.20220378 të datës 28.09.2022; Faturën Nr.20220375 të datës
28.09.2022; Faturën Nr.20220376 të datës 28.09.2022; Faturën Nr.20220377 të datës
28.09.2022; Faturën Nr.20220374 të datës 28.09.2022; Faturën Nr.20220373 të datës
28.09.2022; Faturën Nr. 20220475 të datës 18.11.2022; Faturën Nr.20220498 të datës
14.12.2022; Faturën Nr. 20220499 të datës 14.12.2022; Faturën Nr.20220500 të datës
14.12.2022; Faturën Nr.20220520 të datës 21.12.2022; Faturën Nr.20220521 të datës
21.12.2022; Faturën Nr. 20220522 të datës 21.12.2022; Faturën Nr.20220539 të datës
29.12.2022; Faturën Nr.20220202 të datës 01.06.2022; Faturën Nr.20220250 të datës
30.06.2022; Faturën Nr.20220283 të datës 21.07.2022; Faturën Nr.20220284 të datës
21.07.2022; Faturën Nr.20220285 të datës 21.07.2022; Faturën Nr.20220293 të datës
26.07.2022; Faturën Nr.20220292 të datës 26.07.2022; Faturën Nr.20220297 të datës
29.07.2022; Faturën Nr. 20220295 të datës 29.07.2022; Faturën Nr.20220296 të datës
29.07.2022; Faturën Nr.20220298 të datës 29.07.2022; Faturën Nr.20220121 të datës
31.03.2022; Faturën Nr.20220120 të datës 31.03.2022; Faturën Nr.20220127 të datës
31.03.2022; Faturën Nr.20220126 të datës 31.03.2022; Faturën Nr.20220125 të datës
31.03.2022; Faturën Nr.20220122 të datës 31.03.2022; Faturën Nr.20220123 të datës
31.03.2022; Faturën Nr.20220124 të datës 31.03.2022; Faturën Nr.20220140 të datës
23.04.2022; Faturën Nr.20220174 të datës 30.04.2022; Faturën Nr.20220252 të datës
30.06.2022; Faturën Nr.20220253 të datës 30.06.2022; Faturën Nr.20220254 të datës
30.06.2022; Faturën Nr.20220255 të datës 30.06.2022; Faturën Nr.20220347 të datës
31.08.2022; Faturën Nr.20220350 të datës 31.08.2022; Faturën Nr.20220400 të datës
14.10.2022; Faturën Nr.20220401 të datës 14.10.2022; Faturën Nr.20220444 të datës
31.10.2022; Faturën Nr.20220445 të datës 31.10.2022; Faturën Nr.20220446 të datës
31.10.2022; Faturën Nr.20220469 të datës 18.11.2022; Faturën Nr.20220470 të datës
18.11.2022; Faturën Nr.20220471 të datës 18.11.2022; Faturën Nr.20220472 të datës
18.11.2022; Faturën Nr.20220473 të datës 18.11.2022; Faturën Nr.20220474 të datës
18.11.2022; Faturën Nr.20220487 të datës 24.11.2022; Faturën Nr.20220486 të datës
24.11.2022; Faturën Nr.20220523 të datës 21.12.2022; Faturën Nr.20220399 të datës
14.10.2022; Faturën Nr.20220153 të datës 27.04.2022; Faturën Nr. 20220149 të datës
27.04.2022; Faturën Nr. 20220150 të datës 27.04.2022; Faturën Nr.20220151 të datës
27.04.2022; Faturën Nr.20220152 të datës 27.04.2022; Faturën Nr.20220319 të datës

29.08.2022; Faturën Nr.202300052 të datës 16.02.2023 dhe Faturën Nr.202300090 të datës 25.03.2023, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, gjë e cila vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e tjera të debitorit në këtë procedurë, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimi.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke i'a njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 104.00€, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifatat e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast të parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.990/23, datë 28.05.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.